



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 30.11.2023.

Nga: Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a.,

Adr.: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë.

Për: Operatorin “NAZERI - 2000” SHPK NUIS K31422029Q

Adr: Rr. “Kavajes”, Qendra Condor, Kulla H, Ap. 27, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-82489-10-05-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i Transportit, Shoqërimit dhe ruajtjes së vlerave monetare gjatë transportit, me roje të kategorisë 1.3.B”, Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj, me fond limit 502,240,630 (pesëqind e dy milion e dyqind e dyzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH..

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 06/11/2023, Ora: 10:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 09.10.2023 [84]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruar:

1. Operatori “NAZERI - 2000” SHPK NUIS K31422029Q, me vlerë të ofertës ekonomike 501,530,400 (pesëqind e një milion e pesëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori “Myrto Security” sh.p.k NUIS K23323401N me vlerë të ofertës ekonomike 500,262,013.44 (pesëqind milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e trëmbëdhjetë pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- Operatori **“Myrto Security” sh.p.k NUIS K23323401N** për arsye se:

- Nuk përmbush pikën **2.1/b** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi mungon Formulari i Sigurimit të Ofertës.

- Nuk përmbush pikën **2.2.1.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi në asnjërin nga vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022 nuk ka realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 190% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Nuk përmbush pikën **2.2.3.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi mungon Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 (këstet e maturuara), në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit

- Nuk përmbush pikën **2.2.6.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi nuk disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 ”Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me fushe mbulimi në qarkqet: Shkodër; Lezhë; Kukës; Dibër.

- Nuk përmbush pikën **2.2.7.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi nuk disponon të paktën 56 (pesëdhjetë e gjashtë) automjete të blinduar *për transportin e vlerave monetare*, mjete të cilat duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me qera.

- Nuk përmbush pikën **2.2.10.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi nuk disponon të paktën 56 (pesëdhjetë e gjashtë) shofer për drejtimin e mjeteve të blinduara emrat e të cilëve të figurojnë tek Autorizimet e Mjeteve të blinduara të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

- Nuk përmbush pikën **2.2.13.** të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së pasi nuk disponon Qender Kontrolli, të vërtetuar me akt miratimi sipas Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” të lëshuar nga DPQ-et (Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Gjirokastrë, Kukës, Dibër dhe Korçë).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“NAZERI - 2000” SHPK NUIS K31422029Q, me adresë: Rr. “Kavajes”, Qendra Condor, Kulla H, Ap. 27, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me vlerë 501,530,400 (pesëqind e një milion e pesëqind e tridhjetë mijë e katërqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të veprohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

Nëse Po,

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ardit Demiri